



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "NTSH MS MEDICOM" të datës 31.08.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Kompresor për mbushjen e bombolave të aparateve të frymëmarrjes" me nr. të prokurimit 616-23-5994-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "NTSH MS MEDICOM" të datës 31.08.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Kompresor për mbushjen e bombolave të aparateve të frymëmarrjes" me nr. të prokurimit 616-23-5994-1-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "NTSH MS MEDICOM" (tutje "parashtruesi") me datë 31.08.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Kompresor për mbushjen e bombolave të aparateve të frymëmarrjes" me nr. të prokurimit 616-23-5994-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Pretendimi ankimor Nr. 2: OE I REKOMANDUAR NUK KA IDENTIFIKUAR NË MËNYRË TË QARTË PRODUKTIN KONKRET ME DOKUMENTACION TEKNIK TË MJAFTUESHËM

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga PROGLOBAL SH.P.K. rezulton se janë paraqitur dokumente për disa seri/modelesh të ndryshme të kompresorëve të prodhuesit PARAMINA S.A., kjo bie në kundërshtim të plotë me FDT piken 4.1 Variantet, me ç'rast AK nuk ka lejuar/autorizuar përdorimin e shume varianteve në aspektin e ofërtimit.

Variante autorizohen: Po ☐ Jo ☒

Po ashtu është në kundërshtim edhe me Nenin 29 Variantet e specifikimeve teknike.

Në veçanti: 1. Certifikata MCH/A-A-0878/24

Kjo certifikatë i referohet: **Typhoon Compressors Series 13, 15 dhe 18**, sipas EN ISO 1012-1:2010 dhe Direktivës 2006/42/EC.

2. Certifikata MCH/A-A-0880/24

Kjo certifikatë i referohet: **Cyclone Compressors Series 24, 30 dhe 36.**

3. Certifikata ABS

Dokumenti tjetër i paraqitur i referohet:

Cyclone Silent 30, me numër PR2414663.R1, me datë të vizitës së fundit 7 gusht 2013.

Pra kemi dokumentacion që i referohet Typhoon, Cyclone dhe Cyclone Silent, të cilat nuk janë i njëjti model apo konfigurim.

Në këto rrethana, lind një pyetje themelore:

Cili është produkti konkret për të cilin PROGLOBAL ka ofertuar dhe cili është dokumenti teknik që e identifikon atë produkt?

Nuk është e mjaftueshme që në të njëjtën ofertë të paraqiten certifikata për seri të ndryshme dhe më pas të supozohet se të gjitha këto dokumente dëshmojnë për një produkt të vetëm.

Kërkojmë që AK të tregojë konkretisht dhe dokumentarisht se cili model është ofertuar dhe cilat dokumente të ofertës i referohen atij modeli.

RRPP NR.001/2024 19.11 Specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet t'i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm.

Pretendimi ankimor Nr. 3: CERTIFIKATAT PËR TYPHOON DHE CYCLONE NUK MUND TË KONSIDEROHEN AUTOMATIKISHT SI DËSHMI TË NJË PRODUKTI TË VETËM

Certifikata MCH/A-A-0878/24 mbulon Typhoon Series 13, 15 dhe 18.

Certifikata MCH/A-A-0880/24 mbulon Cyclone Series 24, 30 dhe 36.

Këto janë dy familje të ndryshme produktesh.

Nëse PROGLOBAL ka ofertuar një model të serisë Typhoon, atëherë duhet të dëshmohet se përse një certifikatë që i referohet serisë Cyclone është përdorur si dëshmi për produktin Typhoon.

Nëse, në anën tjetër, PROGLOBAL ka ofertuar Cyclone, atëherë duhet të shpjegohet se si ky produkt përmbush kërkesën e AK-së për kompresor mobil, kur dokumentacioni teknik i Cyclone duhet të shqyrtohet pikërisht në raport me këtë kërkesë, pasi që i njëjti është model statik.

Për këtë arsye, kërkojmë që AK të mos mjaftohet me ekzistencën formale të certifikatave, por të verifikojë fushëveprimin real të secilës certifikatë dhe lidhjen e saj me produktin konkret të ofertuar, si dhe të zbatojnë në mënyrë të duhur Nenin 59.4 të LPP dhe Nenin 28 dhe 29 si dhe kriterin e FDT 4.1. dhe të mos lejoj pranimin e shume varianteve Brenda një oferte, dhe RRPP NR.001/2024 19.11 Specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet t'i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm.

Pretendimi ankimor Nr. 4: MUNGESA E CERTIFIKATËS VALIDE EN 12021:2014

Operatori ekonomik i rekomanduar nuk plotëson as kriterin e kapacitetit teknik dhe profesional të kërkuar në FDT sipas Nenit 69 të LPP, AK në FDT ka kërkuar;

4. Operatori ekonomik duhet të dorëzoj
ISO Certifikata EN 12021:2014

4. Dëshmi mbi dokumentet e ISO Certifikatës EN
12021:2014, me validitet.

Në dokumentet e paraqitura nga OE i rekomanduar nuk është identifikuar certifikatë valide dhe kjo nuk mund të zëvendësohet me certifikatën EN ISO 1012-1:2010, sepse bëhet fjalë për kërkesa dhe objekt certifikimi të ndryshëm.

Për këtë arsye, kërkojmë nga AK të tregojë: Cila është certifikata valide EN 12021:2014, të cilën e ka ofruar operatori ekonomik i rekomanduar, pasi që e njëjta nuk gjendet fare në dosjen e operatorit ekonomik, dokumentet e pranuar në qasjen zyrtare.

Andaj edhe në këtë pikë konsiderojmë se komisioni i vlerësimit dhe AK kanë vepruar në kundërshtim me kriteret e FDT dhe Nenin 59.4 të LPP, duke rekomanduar një operator ekonomik të pa përgjegjshëm dhe pa Certifikata valide për produktin e kërkuar. Ky standard është baza kryesore e produktit pasi që standardi EN 12021:2014 që dëshmon për cilësinë e ajrit të komprimuar që përdoret për mbushjen e bombolave dhe që duhet të jetë i çrëkruar konform këtij standardi kurse AK ka rekomanduar një operator ekonomik me certifikatë jo valide, duke rrezikuar edhe vetë jetën e zjarrefikësve!

Pretendimi ankimor nr. 4: NUK ËSHTË DËSHMUAR KAPACITETI I FILTRIMIT 600 m³

AK ka kërkuar: "kapacitet minimal të pastrimit të ajrit prej 600 m³ në temperaturë 20°C dhe presion 300 bar.

Nga dokumentacioni i paraqitur nga PROGLOBAL nuk rezulton një dëshmi konkrete për këtë parametër të sistemit të filtrimit të modelit konkret të ofertuar.

Andaj pasur parasysh këtë dhe Nenin 28 të LPP dhe UA.NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, Piken 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve theksohet shumë qartë, RRPP NR.001/2024 19.11 Specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet t'i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm.

UA.NR. 002/2024:

- *Mungon specifikimi teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu ("specifikimit teknik" – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzojë specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç ne raste kur OE nuk mund të dorëzojë specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/ perime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do të jenë në përputhje me specifikimin e kërkuar)*
- *Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtijshëm*

Kjo është veçanërisht problematike sepse kapaciteti i filtrimit është një karakteristikë teknike e matshme, dhe jo një çështje që mund të prezumohet nga fakti se prodhuesi prodhon kompresorë me sisteme filtrimi.

Pretendimi ankimor nr. 5: MBROJTJA IP55

AK ka kërkuar mbrojtje minimale: IP55.

Nga analiza e dokumentacionit teknik të modelit Typhoon Open 18E, i cili sipas analizës sonë profesionale është modeli që i përafrohet më së shumti kërkesave të aktivitetit të prokurimit, nuk rezulton se ky model përmbush kërkesën minimale IP55.

Për këtë arsye, nëse PROGLOBAL pretendon se ka ofertuar këtë model, kërkojmë që AK të identifikojë dëshminë teknike konkrete të paraqitur brenda ofertës, e cila provon IP55.

Nuk mund të konsiderohet e mjaftueshme një deklaratë e përgjithshme e OE-së për përmbushjen e Aneksit 1 kur një karakteristikë konkrete e kërkuar nga AK nuk është e dëshmuar me dokumentacion teknik.

Andaj pasur parasysh këtë dhe Nenin 28 të LPP dhe UA.NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, Piken 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve theksohet shumë qartë, RRPP NR.001/2024 19.11 Specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet t'i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm.

Pretendimi ankimor nr. 6: PESHA DHE DIMENSIONET

AK ka kërkuar:

- peshë jo më shumë se 150 kg;
- dimensione jo më shumë se 120 × 60 × 60 cm.

Të dhënat teknike të identifikuar për Typhoon Open 18E tregojnë parametra që nuk përputhen me këto kufizime, veçanërisht sa i përket peshës dhe lartësisë.

Për këtë arsye, nëse ky është modeli konkret i ofertuar nga PROGLOBAL, ekziston një mospërputhje objektive me kërkesat e AK-së.

Nëse PROGLOBAL pretendon se ka ofertuar një konfigurim tjetër, atëherë kërkojmë që AK të identifikojë dokumentin e ofertës që e përcakton atë konfigurim dhe karakteristikat e tij, pasi që i njëjti nuk ofron dëshmi konkrete në ofertë se i plotëson këto kritere.

Andaj pasur parasysh këtë dhe Nenin 28 të LPP dhe UA.NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, Piken 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve theksohet shumë qartë, RRPP NR.001/2024 19.11 Specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet t'i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm.

Pretendimi ankimor nr. 6: SISTEMI I LUBRIFIKIMIT ME POMPË DHE PUNA NË PJERRTËSI 12°

AK ka kërkuar që kompresori të ketë lubrifikim të bllokut me pompë dhe të mund të punojë në teren të pjerrët jo më pak se 12° (shkallë).

Nga dokumentacioni teknik i prodhuesit rezulton se sistemi i lubrifikimit me pompë është i disponueshëm për konfigurime të caktuara.

Por ekzistenca e një opsioni në produktet e prodhuesit nuk dëshmon se konfigurimi konkret i ofertuar nga PROGLOBAL e përmban këtë pajisje.

Po ashtu, nuk është identifikuar dëshmi teknike e qartë që përcakton se konfigurimi konkret mund të përdoret në pjerrësi prej të paktën 12°.

Prandaj kjo kërkesë duhet të verifikohet nga dokumentacioni i ofertës dhe jo të supozohet.

Andaj pasur parasysh këtë dhe Nenin 28 të LPP dhe UA.NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, Piken 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve theksohet shumë qartë, RRPP NR.001/2024 19.11 Specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet t'i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm.

Pretendimi ankimor nr. 7: DEKLARATA PËR TRAJNIMIN – MOSPËRPUTHJE E DREJTPËRDREJTË

Dosja e Tenderit kërkon:

“Operatori Ekonomik është i obliguar t'i dërgojë në akademinë e prodhuesit 2 persona për trajnimin e mirëmbajtjes së kompresorëve dhe të mbulojë shpenzimet e trajnimit, udhëtimit, fjetjes dhe ushqimit.”

Ndërsa dëshmia e kërkuar është deklaratë me shkrim e nënshkruar dhe vulosur nga OE. PROGLOBAL ka deklaruar vetëm:

“Deklarojmë se marrim për obligim të mbulimit financiar të vizitës së dy zyrtarëve të BPZ Prishtinë në fabrikën e prodhuesit.”

Kjo nuk është e njëjtë me kërkesën e AK-së.

PROGLOBAL nuk ka deklaruar shprehimisht:

- se do t'i dërgojë dy persona për trajnim;
- se do të mbulojë koston e trajnimit;
- se do të mbulojë udhëtimin;
- se do të mbulojë fjetjen;
- se do të mbulojë ushqimin.

Në këto rrethana, kërkojmë të sqarohet se mbi çfarë baze Komisioni i Vlerësimit e ka konsideruar këtë deklaratë si përmbushje të kërkesës së DT-së.

Veçanërisht, një "vizitë në fabrikë" nuk mund të konsiderohet automatikisht e barabartë me trajnim profesional në akademinë e prodhuesit, i cili përbën një obligim të veçantë dhe me kosto. Kjo deklaratë nuk është në harmoni me kërkesën e kërkuar në FDT dhe nuk ofron garanci dhe siguri për atë së çka AK ka kërkuar.

Pretendimi ankimor nr. 8: DEKLARATA E PROGLOBAL PËR ANEKSIN 1 NUK ËSHTË DËSHMI PËR SECILIN PARAMETËR

AK ne FDT ka kërkuar:

Specifikacionet teknike të detyrueshme	3.1	Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.
--	-----	--

PROGLOBAL ka paraqitur deklaratë për përmbushjen e Aneksit 1.

Megjithatë, kjo deklaratë është një deklaram unilateral i operatorit ekonomik. Por qe i njëjti nuk ka ofruar specifikim teknik dhe dokumentet e specifikuar në Aneksin nr.1. siç kërkohen dhe të njëjtat nuk përputhen dhe i njëjti ka ofertuar në disa variante të ndryshme në kundërshtim me LPP Nenin 29 dhe FDT piken 4.1.

Andaj pasur parasysh këtë dhe Nenin 28 të LPP dhe UA.NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, Piken 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve theksohet shumë qartë, RRPP NR.001/2024 19.11 Specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet t'i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm.

Pretendimi ankimor nr. 9: CERTIFIKATAT E PARAQITURA NUK DËSHMOJNË AUTOMATIKISHT TË GJITHA DIREKTIVAT DHE STANDARDET E KËRKUARA

Nga dokumentacioni i PROGLOBAL rezulton se është paraqitur certifikata EN ISO 1012-1:2010 sipas Direktivës 2006/42/EC.

Ndërkohë, AK ka kërkuar dëshmi lidhur me:

- 2014/30/EU;

- 2014/35/EC;
- 2006/42/EC;
- 2014/68/EU;
- EN 12021:2014.

Prania e një certifikate që i referohet vetëm një direktive nuk dëshmon automatikisht përmbushjen e të gjitha direktivave dhe standardeve të tjera të kërkuara.

Për këtë arsye, kërkojmë nga AK të identifikojë dokumentet konkrete në ofertën e PROGLOBAL që dëshmojnë secilën prej kërkesave të mësipërme.

Në veçanti, kërkojmë të identifikohet dëshmia për EN 12021:2014, e cila është veçanërisht e rëndësishme për cilësinë e ajrit të komprimuar për aparatet e frymëmarrjes.

Pretendimi ankimor nr. 10: PËRDORIMI I DOKUMENTEVE TË MODELEVE TË NDRYSHME

PROGLOBAL ka paraqitur dokumente për disa lloje dhe modele të kompresorëve:

- Typhoon Series 13/15/18;
- Cyclone Series 24/30/36;
- Cyclone Silent 30.

Nëse këto dokumente janë përdorur së bashku për të dëshmuar përmbushjen e një produkti të vetëm, kërkojmë që AK të shpjegojë **bazën teknike dhe dokumentare për këtë lidhje.**

Nuk mjafton që dokumentet të jenë të lëshuara në emër të të njëjtit prodhues.

Duhet të dëshmohet se ato i referohen pikërisht produktit dhe konfigurimit të ofertuar.

Në të kundërtën, krijohet situata ku karakteristikat e një modeli mund të përdoren për të plotësuar boshllëqet dokumentare të një modeli tjetër.

Kjo do të ishte në kundërshtim me parimin e vlerësimit objektiv dhe me kërkesën që tenderi të përputhet me kërkesat e DT-së.

Andaj pasur parasysh këtë dhe Nenin 28 të LPP dhe UA.NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, Piken 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve theksohet shumë qartë, RRPP NR.001/2024 19.11 Specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet t'i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm.

Pretendimi ankimor nr. 11: NENI 59.2 – SAKTËSIMI NUK MUND TË KTHEHET NË PLOTËSIM MATERIAL TË OFERTËS

E theksojmë këtë çështje për shkak të rëndësisë së saj.

Neni 59.2 i LPP-së lejon që AK të kërkojë sqarim me shkrim për ndonjë aspekt të tenderit, por përcakton shprehimisht se:

“Asnjë ndryshim në ndonjë kusht material apo aspekt material të tenderit nuk duhet të kërkohet ose të pranohet...”

Pra, sqarimi nuk mund të shndërrohet në mekanizëm për plotësimin e dokumenteve materiale që mungojnë ose për ndryshimin e karakteristikave të ofertës.

Nëse pas hapjes së ofertave PROGLOBAL do të kërkohej të paraqiste për herë të parë:

- Certifikatë EN 12021:2014;
- Dëshmi të kapacitetit të filtrimit;
- Deklaratën për trajnimin e dy personave;
- Dokument për IP55;
- Dokument për peshën/dimensionet;
- Dokument për pjerrtësinë e punës;
- Ose dokument tjetër material që nuk ka qenë pjesë e ofertës,

atëherë AK duhet të vlerësojë nëse një veprim i tillë do të përbënte plotësim material të ofertës, në kundërshtim me Nenin 59.2.

Pretendimi ankimor nr. 12: KËRKESA PËR ARSYETIM TË PLOTË TË VENDIMIT

Nëse AK konsideron se oferta e PROGLOBAL është e përgjegjshme, kërkojmë që në vendimin mbi këtë kërkesë të identifikojë në mënyrë konkrete:

1. Modelin e saktë të kompresorit të ofertuar;
2. Dokumentin që identifikon modelin;
3. Dokumentin që dëshmon kapacitetin 300 l/min;
4. Dokumentin që dëshmon IP55;
5. Dokumentin që dëshmon peshën;
6. Dokumentin që dëshmon dimensionet;
7. Dokumentin që dëshmon sistemin e lubrifikimit me pompë;
8. Dokumentin që dëshmon punën në pjerrësi $\geq 12^\circ$;
9. Dokumentin që dëshmon kapacitetin e filtrimit $\geq 600 \text{ m}^3$;
10. Certifikatën valide EN 12021:2014 e lëshuar nga trup i tretë;
11. Dokumentet për direktivat 2014/30/EU, 2014/35/EC, 2006/42/EC dhe 2014/68/EU;
12. Dokumentin që dëshmon përmbushjen e kërkesës për trajnim të dy personave;
13. Arsyetimin se përse dokumentet e Typhoon dhe Cyclone janë konsideruar relevante për produktin konkret të ofertuar.

Një përgjigje e përgjithshme se "Komisioni i Vlerësimit ka shqyrtuar ofertën dhe e ka konsideruar të përgjegjshme" nuk do të ishte e mjaftueshme për të adresuar pretendimet konkrete të paraqitura në këtë kërkesë.

Pretendimi ankimor nr. 13: KËRKESA PËR RISHQYRTIM

Duke u bazuar në të gjitha sa më sipër, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues:

1. Të pranojë këtë Kërkesë për Rishqyrtim si të bazuar.
2. Të rishqyrtojë vendimin për përzgjedhjen e **PROGLOBAL SH.P.K.** si tenderues i suksesshëm.
3. Të konstatojë nëse oferta e PROGLOBAL përmbush të gjitha kërkesat e detyrueshme të Dosjes së Tenderit.

4. Të verifikojë dokumentacionin teknik të PROGLOBAL vetëm në raport me modelin konkret dhe konfigurimin konkret të ofertuar.
5. Të verifikojë vlefshmërinë dhe fushëveprimin e të gjitha certifikatave të paraqitura.
6. Të verifikojë në mënyrë të veçantë ekzistencën e certifikatës valide EN 12021:2014 të lëshuar nga trup i tretë për kompresorin së bashku me sistemin e filtrimit.
7. Të verifikojë dëshminë për kapacitetin e filtrimit prej së paku 600 m³.
8. Të verifikojë përputhshmërinë me IP55, peshën, dimensionet, lubrifikimin me pompë dhe të gjitha parametrat e tjerë të përcaktuar në Aneksin 1.
9. Të verifikojë mospërputhjen ndërmjet kërkesës për trajnim në akademinë e prodhuesit dhe deklaratës së PROGLOBAL për "vizitë në fabrikë".
10. Nëse konstatohet se PROGLOBAL nuk i ka përmbushur ose nuk i ka dëshmuar kërkesat e detyrueshme të Dosjes së Tenderit, të ndryshojë vendimin e dhënies së kontratës dhe të ndërmarrë veprimet e parashikuara me LPP.
11. Të na komunikohet një vendim i arsyetuar për secilin pretendim të paraqitur në këtë kërkesë.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se komisioni vlerësues profesional ka ekzaminuar, krahasuar dhe vlerësuar ofertat në këtë aktivitet të prokurimit dhe me këtë rast ka gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë më të shtrenjtë sesa tenderuesi i rekomanduar për kontratë. Po ashtu ka gjetur se tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka prezantuar të gjitha certifikatat, pajisjet/produktet dhe dëshmitë tjera dokumentare të kërkuara sipas DT.

Në këtë mënyrë tenderuesi i rekomanduar ka dëshmuar jo vetëm që ka dorëzuar ofertë të përgjegjshme por edhe më të lirë sesa parashtruesi. Për këto arsye komisionit vlerësues i është faluar besimi i plotë ndërsa të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 08.09.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.